



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Duke u bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit ne Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës , *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

KONKURS

1. Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit , tri (3) pozita te karrierës:

Titulli: Një (1) Zyrtar për statistika ne Pejë

Numri i referencës : ASK-DRA-002

Koeficienti : 6

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Kryen plotësimin dhe monitorimin e Indeksit te çmimeve te konsumit,
- Kryen plotësimin , monitorimin dhe kontrollimin e **Raporteve të hotelerisë dhe turizmit**
- Monitorimi mujor i çmimeve , kontakton me responentet,
- Udhëzon plotësimin e formularëve te anketave statistikore,
- Bën analizën logjike te hulumtimeve statistikore,
- Kujdeset për shpërndarjen distribuimin dhe grumbullimin e raporteve ne teren ,
- Me kërkesën e udhëheqësit të Zyrës rajonale , përcjell dhe monitoron personat e angazhuar ne teren gjatë procesit te implementimit te projektit.
- Raporton te udhëheqësi i zyrës rajonale për dinamikën e aktiviteteve sipas agjendës qe ka parashtruar Departamenti i ASK.

Kualifikimi Përgatitja universitare-Fakulteti nga fushat ekonomike, juridike, shkencat shoqërore apo te ngjashme .

Përvoja e punës: kandidati duhet të ketë 2 vite përvojë pune.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Kandidati duhet të ketë aftësi të komunikimit për pune ekipore ,
- aftësi ne përdorimin e kompjuterit (Wordit , Excelit , Outlook) , te ketë aftësi te ruajtjes se konfidencialitetit të të dhënave që kanë të bëjnë me punën.

- Shkathësi ne realizimin e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor te zyrës rajonale ,
- Shkathësi të mira të komunikimit , përfshirë aftësinë për të interpretuar informata , dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;

Procedura e konkurimit:

Ne Shërbimin Civilë kane te drejte te punësohen shtetasit e Republikës se Kosovës te moshës madhore ,te cilët kane zotësi te plote për te vepruar,përgatitje te nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe te cilët kane aftësi fizike qe kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore qe e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë behet ne pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Republikës se Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit ne Shërbimin Civilë.

Kohëzgjatja e emërimit:Sipas Ligjit te Shërbimit Civil te Republikes se Kosoves , ne te cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Konkursi është i hapur 15 dite kalendarik nga dita e publikimit ne mjetet e informimit publik.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave te Kosovës,Rr, "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën ,vertetimin nga Gjykata qe personi nuk eshte nene hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni.

Kërkesat e derguara pas dates se fundit nuk do te pranohen.Kërkesat e pakompletuara do te refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do ti nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

“Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi te barabarta te punësimit per te gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga te gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga te gjitha komunitetet ne Kosovë.

“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

